

3.03.1998, ata u varrosën në varrezat e Likoshanit/Likošane.

**Burimet:** deklarata S.R, FDH-15201; deklarata S.H, FDH-12045; deklarata R.I, FDH-12044.

### Hajdin (Vesel) Makolli

(6.08.1940, shqiptar nga Çikatova e Vjeter/Staro Çikatovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, pesë fëmijë, axhustator)

Hajdini ka punuar në fabrikën e *Ferronikelit* në Gllgoc/Glogovac. Në datën **1.03.1998**, rreth orës 15:00, Hajdini u kthye nga puna në shtëpi në **Çikatovën e Vjeter/Staro Çikatovo**. Përderisa me djalin Milaimin po kalonin nga shtëpia e vjetër në atë të re, një plumb e ka qëlluar atë në këmbën e majtë. Plumbi ka ardhur nga postblloku policor, i cili gjendej te shkolla fillore, afro 400 metra larg shtëpisë së tyre. I vëllai Tahiri dhe i biri Milaimi e çuan menjëherë Hajdinin në ambulancën e fshatit ku ia ndalën gjakderdhjen. Pastaj, e dërguan në spitalin e Prishtinës/Priština. Në datën 7.03.1998, Hajdinin e lëshuan nga spitali dhe ai, deri në muajin korrik, ka qëndruar te familja në Çikatovën e Vjeter/Staro Çikatovo. Atëherë, nga droja prej sulmit të mundshëm të forcave serbe, të cilat ishin të pozicionuara te *Ferronikeli*, që të gjithë u zhvendosën në Qirez/Ćirez. Gjendja shëndetësore e Hajdinit nisi atëherë të përkeqësohej, sepse plaga në këmbë iu infektua. Në datën 22.09.1998, ai dhe familjarët u detyruan të braktisnin edhe Qirezin/Ćirez. U strehuan në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*. Pas dy ditësh të jetës nën qiell të hapur dhe në pyll [24.09.1998], Hajdini ndërroi jetë nga pasojat e plagosjes. Në mbrëmje, familjarët e kanë varrosur në pyll. Pas mbarimit të luftës, në muajin gusht të vitit 1999, trupi i Hajdinit është rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin e lindjes.

**Burimet:** deklarata N.M, FDH-20285; deklarata M.M, FDH-28129.

### Daut (Zenun) Halilaj

(16.10.1933, shqiptar nga Tërdeci/Trdevac, komuna e Gllgocit/Glogovac, mësues, dhjetë fëmijë)

### Mehmet (Feriz) Halilaj

(19.08.1970, shqiptar nga Tërdeci/Trdevac, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Dauti ka qenë mësues në shkollën fillore në Obrinë e Epërme/Gornje Obrinje, ndërkaq Mehmeti punonte në fabrikën e *Ferronikelit* në Gllgoc/Glogovac për një kohë të gjatë. Dauti ka aderuar në UÇK në vitin 1997, ndërkaq Mehmeti pas ngjarjeve në Likoshan/Likošane dhe Qirez/Ćirez [shkurt 1998]. Ata kanë rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **29.03.1998** në pyllin që quhet *Balli i Madh* dhe gjendet përkaj fshatit [**Tërdec/Trdevac**]. Familjarët i kanë varrosur Mehmetin dhe Dautin në varrezat e Tërdecit/Trdevac, në mëngjesin e datës 30.03.1998.

**Burimet:** deklarata B.H, FDH-28132; SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 83-86, FDH-24681; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Ramiz (Imer) Leku

(10.9.1971, shqiptar nga Bajica/Banjica, komuna e Gllgocit/Glogovac, nëpunës, një fëmijë)

Ramizi ishte i punësuar si referent në Komunën e Gllgocit/Glogovac. I ati i punonte si gardian në komunë dhe atë e vranë në vitin 1996, përderisa me Ramizin po kthehej nga puna. Policia i ka ndërmarr hetimet e rastit, por kurrë nuk i ka zbuluar vrasësit. Ramizi jetonte në bashkësinë familjare me gruan Shukrijen, nënën Mihanen, vëllezërit dhe motrat në fshatin **Bajicë/Banjica**. Si çdo mëngjes tjetër, Ramizi u nis në punë me makinën e vet edhe në datën **10.04.1998**. Nëna e kishte përcjell deri te kapia e oborrit. Por, vetëm një minutë më vonë, ajo i dëgjoi disa të shtëna. Vëllezërit e Ramizit dolën jashtë dhe vrapuan drejt vendit nga i cili u dëgjuan të shtënat. E gjetën trupin e pajetë të Ramizit afro 200 metra larg shtëpisë. Ishte i shtrirë në makinë, e cila gjendej e ndalur pranë pikës së karburanteve, që ishte afër shtëpisë së tyre. Pas kryerjes së hetimeve në vendngjarje, policia e ka çuar trupin e Ramizit në Prishtinë/Priština për obduksion. Të nesërmen, trupi i tij i është kthyer familjes. Po atë ditë, Ramizi u varros në varrezat lokale.